



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1327/18 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM

Nr.254, datë 29.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 143, DATË 30.06.2017,
NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 143, datë 30.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të dërguar nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, *****, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1327 prot., datë 27.06.2017”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet shkresës nr. 1327 prot., datë 27.6.2017, nëpunësi ***** me detyrë Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ka informuar Komisionerin se, ndaj tij ka filluar një procedurë disiplinore, si dhe ka vënë në dukje disa parregullsi të konstatuara prej tij, të cilat kanë lidhje me mosrespektimin e procedurës ligjore nga ana e Komisionit të Disiplinës, i ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë, si institucioni nga i cili ka varësinë Instituti i Mjekësisë Ligjore. Për këtë arsye, Komisioneri ka filluar hetimin administrativ dhe ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion. Ky proces është përmblyllur me Vendimin Nr. 143, datë 30.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të dërguar nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, *****, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1327 prot., datë 27.06.2017”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Ministri i Drejtësisë, që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të

Urdhrit nr. 3826, datë 8.6.2017, “Për ushtrimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë në mungesë të tij” dhe të anulojë Urdhrit nr.4052/4, datë 21.6.2017, “Mbi krijimin e komisionit për fillimin e procedurës disiplinore për *****”.

2. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës, që të anulojë të gjitha aktet administrative që materializojnë ecurinë disiplinore, duke filluar nga shkresa nr. 4052/3, datë 20.6.2017, “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore”, e deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar, nr.4052/8, datë 28.6.2017, “Për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për *****”, si akte të nxjerra mbi bazën e një akti vendimi absolutisht të pavlefshëm dhe procesi të fillojë nga e para.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 143, datë 30.06.2017, me shkresën nr. 1837 prot., datë 30.11.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit Nr. 143, datë 30.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të dërguar nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, *****, nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1327 prot., datë 27.06.2017””, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Joni Marko, Specialist pranë kësaj drejtorie, të cilët në datën 01.12.2017, u paraqitën në insitucionin e Ministrisë së Drejtësisë.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmërues. Dokumentacioni shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 01.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në **pikën 1 të vendimit** paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Drejtësisë që për të rregulluar situatën e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit nr. 3826 prot., datë 08.06.2016, dhe të Urdhrit 4052/4, datë 21.06.2017, si akte administrative absolutisht të pavlefshme.

Më tej, në **pikën 2 të vendimit**, Komisioneri ka kërkuar nga Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë, të anulojë të gjitha aktet administrative që materializojnë ecurinë disiplinore, duke filluar nga shkresa nr. 4052/3, datë 20.6.2017, “Njoftim mbi

fillimin e ecurisë disiplinore”, e deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar, nr.4052/8, datë 28.6.2017, “*Për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” për Z. ******”, si akte të nxjerra mbi bazën e një akti vendimi absolutisht të pavlefshëm dhe procesi të fillojë nga e para.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se nga Ministri i Drejtësisë dhe Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë nuk ishte marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të pikave 1 dhe 2 të vendimit objekt verifikimi (*nga komunikimi me personin e kontaktit të institucionit të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtori i Shërbimeve të Brendshme, grupi i punës u informua se ***** vazhonte marrëdhënien e punës në pozicionin Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore*).

Ndërkohë rezulton se nëpunësi ***** , në datën 11.07.2017, i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me anë të së cilës ka kërkuar konstatimin e paligjshmërisë së Vendimit Nr. 4052/8, datë 28.06.2017, të Komisionit Disiplinor “*Për marrjen e masës disiplinore ‘Largim nga shërbimi civil’*”, marrë ndaj tij.

Me Vendimin Nr. 3462 (80-2017-3334), datë 13.09.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: *1. Pranimin e padisë së paditësit *****; 2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 4052/8, datë 28.06.2017, të KD; 3. Detyrimin e palës së paditur (Ministrisë së Drejtësisë) për të rregulluar pasojat e krijuara nga akti i mësipërm; 4. Detyrimi i palës së paditur për rikthimin në pozicionin e mëparshëm si Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore...; 5. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm...* Në zbatim të këtij vendimi, Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ***** është rikthyer në detyrë dhe vazhdon të ushtrojë funksionet në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

Ministria e Drejtësisë e ka ankimuar këtë vendim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në kushtet kur çështja është duke u shqyrtuar nga gjykata, bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i RSH*”, në të cilin përcaktohet se institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 143, datë 30.06.2017, “*Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të dërguar nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ***** , nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1327 prot., datë 27.06.2017*”, të Komisionerit, propozojmë përfundimin e procesit të verifikimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 143, datë 30.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të dërguar nga Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, ***** , nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr.1327 prot., datë 27.06.2017”, në institucionin e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha